



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 25. 11. 2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Biserka Kostiq Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Duda Balje dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula.

Te ftuar: Arben Limani-AKP, Reshat Fetahu-AKP, Halil Hoxha dhe Maliq Hoxha-Këshilli i fshatit Bellanicë.

Pjesëmarrës të tjerë: Sali Morina-deputet, Ukë Gashi- ZPRK, Pleurat Kurti- EUSR, Florije Kryeziu- UNICEF, Ervin Ibrahim-UNDP, Nuredin Ibishi- këshilltar i kryetares së Komisionit nga CDF-i, dhe Burim Tahiri-praktikant.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi Suazan Novoberdaliu, kryetare, e cila konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24 dhe 31 tetor 2011;
3. Shqyrtimi i Peticionit të Këshillit organizativ nga fshati Bellanicë- KK Malishevë;
4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryqit të Kuq të Kosovës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja – I propozoi Komisionit, që rendit të ditës t'i shtohet si pike e veçantë, shqyrtimi i kërkesës që Komisioni të bëhet komision i përhershëm.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24 dhe 31 tetor 2011

Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 24 dhe 31 tetor 2011.

3. Shqyrtimi i Peticionit të Këshillit organizativ nga fshati Bellanicë - KK Malishevë

Kryetarja- Falënderoi për pjesëmarrje përfaqësuesit e AKP-së dhe të fshatit Bellanicë të Komunës së Malishevës. Ajo theksoi se Komisioni ka caktuar dy anëtarë që merren me shqyrtimin e peticioneve dhe lidhur me këtë petition hapi debat.

Rita Hajzeraj- I përshëndeti të pranishmit dhe tha se për disa peticione, nëse e shohim të arsyeshme, të dalim në terren që të shohim se si ekziston gjendja reale, pa marrë parasysh se i çfarë natyre është peticioni.

Ne kemi qenë në Bellanicë dhe kemi marrë të gjitha informatat të cilat i posedojnë qytetarët dhe sot e kemi parë të arsyeshme të ballafaqohen këtu të gjitha palët e involvuara dhe të sqarohet se si ka ndodhur privatizimi i atyre pronave.

Halil Hoxha, kryetar i Këshillit organizativ i fshatit Bellanicë- E njoftoi Komisionin lidhur me statusin e pronave kontestuese, si dhe mënyrën si iu ka marrë prona nga ndërmarrja “Mirusha” gjatë viteve '59 - '60 , me qëllim që të vendosen kolonë në ato prona.

Ai në vija të trasha përshkroi gjendjen deri në vitin 2007, kur është bërë privatizimi i këtyre pronave nga AKM- ja. Në fund tha se banorët e fshatit posedojnë dokumentacion përkatës ku dëshmohet se këto ishin prona private të tyre.

Kryetarja- Kërkoi sqarim shtesë lidhur me lëndët në gjykata dhe me çfarë baze juridike i ka marrë ato prona “Mirusha”.

Albana Gashi- Tha se tokat qenkan marrë në vitet '59 –'60 për t'u kolonizuar me kolonë serbë dhe malazezë. Më intereson se mbas luftës çfarë është bërë me ato prona, d.m.th nuk janë kthyer më, çka ka ndodhur me ato prona?

Kurtan Kajtazi- Tha se kemi qenë edhe në vendin e ngjarjes, kemi takuar fshatarët dhe të gjitha faktet dhe dëshmitë e tyre, që ata i kanë, dëshmojnë se prona ka qenë e tyre, kanë kopjet e planit, disa dëshmojnë se u janë djegur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Unë desha të di se cila rrugë është ndjekë dhe a ka bërë shkelje të ligjit Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe cilat fakte i ka ndjekë kjo Agjenci për të privatizuar këtë pronë, kur ka lëndë për kontestime pronësore, Agjencia nuk ka të drejtë ta privatizojë atë pronë.

Reshat Fetahu- AKP (drejtor i Zyrës ligjore në AKP), tha se nuk është e arsyeshme të jepen informata bazike, sepse prezentë janë përfaqësuesit e fshatit të cilët janë në gjendje dhe i dinë të gjitha këto prona, prej pronës së një ndërmarrje, agjencia ka të drejtë të themelojë disa persona juridikë, prej pronave të Kombinatit bujqësor në Malishevë janë formuar dy persona juridikë, emrat nuk i kam, ata emra kanë mundur edhe të ndërrohen sepse prej vitit 2007 ato prona kanë mundur edhe të shitën.

Kurtan Kajtazi- Neve na intereson se a ka pasur konteste, pasi që pronarët kanë fleta poseduese, kanë dokumentacione, a ka pasur ankesa si ka ndodhur ky privatizim, a i ka shqyrtuar Agjencia Kosovare e Privatizimit të gjitha këto gjatë privatizimit të këtyre pronave.

Reshat Fetahu- Tha se AKP-ja është e obliguar t'i respektojë ligjet të cilat operojnë në këtë shtet, ne informatat i marrim në kadastrë, çdokund që ka ndryshim kadastral neve na pengon automatikisht, këto janë konteste gjyqësore, është e vërtetë, por vetë paraqitësi i petitionit nuk do të thotë se ka të drejtë, unë prej drejtorit për Kadastrë kisha kërkuar historinë dhe kronologjinë e këtyre pronave.

Rita Hajzeraj- Tha se çka ndodh nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës iu kthen përgjigje pozitive këtyre njerëzve.

Reshat Fetahu- Ne do të ishim te lumtur nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës iu kthen përgjigje të tillë.

Ne kur bëjmë privatizimin, si informacion të parë marrim vetë ndërmarrjen.

Ndërmarrja ka librat e saj, regjistrimin e aseteve, librat për regjistrimin e inventarit, pastaj shkojmë në kadastrë i drejtohem gjykatës komunale konkrete, marrim vërtetim nga gjykata nëse ka ndonjë kontest në gjykatë për atë pronë, a ka ndonjë pengesë apo hipotekë, nëse s'ka, marrim një vërtetim dhe i drejtohem kadastrës nëse ka diçka në ekzekutim. Kjo është një procedurë paraprake, procedurë para se të shkohet në bord, unë them se është mirë që në një takim tjetër të jetë prezent edhe drejtori i kadastrës.

Kimete Bytyçi- Tha se në çfarë baze është bërë transformimi i këtyre pronave tek pronarët e rinj.

Reshat Fetahu- Tha se Agjencia e Privatizimit me rregulloren 2003/13, e cila është ende në fuqi, e ka të drejtën e transformimit të qerabartjes, ne shesim qerambajtjen për 99 vite ne nuk shesim titullin e procesin, mbas 99 viteve, serish prona i kthehet shtetit. Kjo është ajo baza ligjore që i jep Agjencisë të drejtën për të bërë bartjen e të drejtave në pronë, ne bartim të drejtën e posedimit dhe të shfrytëzimit.

Albana Gashi- Ne po e dimë të gjithë si u është marrë prona në atë kohë, por po na shqetëson fakti se qysh tani po ua japin të drejtën këtyre personave me dëshmi pronësie, të dalë toka në privatizim, dhe pa kthyer përgjigje Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

Kryetarja- Unë mendoj se zgjidhja duhet kërkuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Më intereson të di se a jeni drejtuar në atë Dhomë të Posaçme të Gjykatës Supreme?

Kurtan Kajtazi- Tha se ka një propozim për ta lehtësuar punën që në një mbledhje të ardhshme të Komisionit edhe përfaqësuesit e fshatit Bellanicë, të AKP-së, si dhe drejtori i Kadastrës, të marrin pjesë dhe ta shqyrtojnë lëndën edhe më mirë dhe të gjithë t'u ndihmojmë përfaqësuesve të fshatit, në mënyrë që t'ua lehtësojmë rrugën për ta përcjellë dokumentacionin në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Kryetarja- Ua përkujtoj se Komisioni nuk e ka në kompetencë të përzihet në punën e gjyqësorit, prandaj gjykata është e pavarur në marrjen e vendimeve të veta, për të vendosur për rastet. Ajo më tutje shtoi se qëllimi i takimeve është marrja e informacioneve për t'ua lehtësuar punën palëve, kemi nevojë për informata shtesë nga ana e kadastrës. Në mbledhjen tjetër do t'ju ftojme të gjithëve dhe do ua dërgoj ftesën dhe materialin me kohë.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryqit të Kuq të Kosovës,

Kurtan Kajtazi- Tha se kërkesa ishte shumë e qartë, e kam analizuar dhe tha se i ka bërë edhe një pyetje ministrit të Financave pse nuk po zbatohet kjo.

Kryetarja- Tha se jam e njoftuar me këtë kërkesë. Ata kanë qenë tek unë paraprakisht, me Ligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës është vendosur që 1% bruto shitjes së vlerës së polisave të sigurimit të shkojnë në fondin e Kryqit të Kuq të Kosovës. Këtë nen të projektligjit, nuk e respektojnë kompanitë e sigurimeve, janë ankuar edhe ne Gjykatën Kushtetuese, kompanitë e sigurimeve monitorohen nga BQK-ja, respektivisht Departamenti për Mbikëqyrjen e Kompanive të Sigurimeve. BQK-ja është ajo që i monitoron dhe i sanksionon për mospërbushjen e detyrimeve që i kanë. Unë i kam njoftuar ata se kompetencat tona janë që ta shkruajmë një shkresë dhe t'ia dërgojmë BQK-së dhe kompanive të sigurimeve se e kemi shqyrtuar këtë kërkesë të Kryqit të Kuq dhe konsideroj se kompanitë e sigurimeve janë duke e shkelur ligjin. BQK-ja të monitorojë, që në një mënyrë, të detyrojë që të respektohet Ligji për pagesën e 1%.

P e r f u n d i m

Komisioni unanimisht vendosi që t'i drejtohet me shkresë BQK-së, Kryqit të Kuq, Ministrisë së Financave se e ka shqyrtuar kërkesën e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe se këto organe duhet të bëjnë zbatimin e Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës.

5 Shqyrtimi kërkesës që Komisioni të bëhet komision i përhershëm.

Kryetarja - Njoftoj anëtarët e Komisionit se Komisioni ynë e ka bërë kërkesën që të jetë komision i përhershëm, me qëllim që çdo ligj të kalojë përmes këtij komisioni, të shikojmë

se a ka shkelje të të drejtave të njeriut dhe shkelje të barazisë gjinore, ne kemi kompetencë tek të drejtat e njeriut, por nuk kemi edhe për të drejtat e fëmijëve e cila është fushë e ndjeshme dhe është mirë që edhe këto kompetenca t'i kemi si komision. Ne e kemi një shkresë nga UNICEF-i, i cili iu ka drejtuar Kryeparlamentarit, neve si Komision, Komisionit për Rregullore të Punës, Mandate dhe Imunitete. Këtu janë kompetencat që i kanë paraparë për këtë fushë edhe në Raportin e Progresit, shqetësimin e kemi për të drejtat e fëmijëve, ne po marrim vendim, që nëse Komisioni për Rregullore se ka kryer ende punën, ne t'i drejtohem Kryesisë dhe nënkomisionit që të përfshihen edhe këto në kompetencën e Komisionit tonë.

5. Të ndryshme

Kryetarja- Tha se për monitorimin e Ligjit për liritë fetare është përfunduar, nëse ka dikush për të shtuar apo ndryshuar në raport, ju lutem t'i paraqitni në Komision.

Kymete Bajraktari- Unë në rekomandimin numër 6 kërkoj që të bëhet „të funksionalizohen këshillat e bashkësive islame nëpër komuna”, gjithashtu tha se rekomandimi nr. 4 të hiqet sepse është i tepërt, si dhe rekomandimi numër 8.

Kurtan Kajtazi- Tha se nëse ka mundësi, raportin mos ta miratojmë sot dhe ta shqyrtojmë edhe njëherë sepse unë i kam disa paqartësi, do ta analizojmë edhe një herë dhe t'i harmonizojmë qëndrimet.

Kryetarja- Tha se propozimet që u bënë nga Kymetja, të inkorporohen në raport, gjithashtu nëse edhe dikush tjetër ka ndonjë ndryshim a plotësim, le t'i sjellë me shkrim dhe raportin të jetë në mbledhjen tjetër i gatshëm për miratim në Komision dhe të procedohet për miratim në seancë plenare.

Ajo njoftoi se ne kemi ra dakord që të bëjmë monitorimin e Ligjit për barazi gjinore, dhe e njoftoi Komisionin për përkrahjen prej UNDP-së dhe së bashku me komisionin të bëjë monitorimin e ligjit, pra të na ofrojnë mbështetje, prandaj lidhur me këtë, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni unanimisht e përkrahu iniciativën e UNDP-së që të ndihmojë Komisionin në monitorimin e Ligjit për barazi gjinore.

Kryetarja e informoi Komisionin me aktivitetet që do t'i ketë gjatë ditëve në vijim lidhur me Ditën Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, Ditën Ndërkombëtare për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, aktivitetet gjatë muajit dhjetor.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu